

Unique Identification Number: 810831124
Business Registration Number: 70985950
Fiscal number: 601010531
VAT Number: 330207573



Str. Tahir Zajmi n.n
10000 Pristina, Republic of Kosovo
Phone: +383 (0) 38 732 732
Fax: +383 (0) 38 732 731
Web: www.storm-ict.com
E-mail: info@storm-ict.com

Për: Organi Shqyrtues i Prokurimit
Tema: Ankesë
Titulli i tenderit: Furnizim me pajisje të IT-se
Nr. i Prokurimit: 250-25-133-5-5-8
Datë: 28 Shkurt, 2025

ANKESA – FAKTET DHE ARGUMENTET

Ne GOE Storm ICT L.L.C dhe Safebit L.L.C pasi që jemi GOE i kualifikuar nga marreveshja kornize me nr. të prokurimit UA/2016-24-3927-1-1-1 dhe pas pranimit të FPO-se nga AK (Keshilli Prokurorial i Kosovës) kemi verejtur se AK ka ndryshuar specifikat baze nga marreveshja kornize por jo edhe siq parashihet në kontratë që AK-të gjatë fazës së përpilimit të specifikimeve teknike mund të kërkojnë specifika më të avancuara se sa ato në marreveshjen kornize apo specifikat bazike.

Pas kësaj ne kemi kërkuar Informacione Shtese ku edhe kemi bërë pyetjet në lidhje me keto specifikime baze që janë publikuar. Me poshte ne do të i listojmë pyetjet që kemi bërë në kërkesën tonë për informacione shtese si dhe përgjigjet e pranuar nga AK, dhe replikën tonë ndaj kësaj përgjigjeje së bashku me kërkesën tonë.

Pika 1 : Tek ANEKSI 1, "BrandName PC Model II," ju lutemi sqaroni çështjen e porteve, pasi keni kërkuar minimumi 6 porta, ku përfshihen 4 USB 3.0 dhe 2 USB 2.0, ndërsa në fund është përmendur edhe një specifikim për 4 porta USB. Ju lutemi konfirmoni nëse kërkesa për portet USB është në përputhje me Kontratën Publike Kornizë në fazën e parakualifikimit.

Përgjigja nga AK Pika 1: Sqarim: Kërkesa është për gjithsej 6 porta USB, nga të cilat 4 duhet të jenë USB 3.0 dhe 2 duhet të jenë USB 2.0. Të gjitha specifikat që janë më të avancuara se ato të përfshira në dosjen e tenderit janë të pranueshme për AK.

Përgjigja nga OE Pika 1: Ne pajtohemi me sqarimin e dhënë nga AK.

Pyetja 2.: Tek ANEKSI 1, për produktin "BrandName PC Model II," keni specifikuar si kërkesë për portet video HDMI dhe VGA. Kërkojmë që kjo të zëvendësohet me kërkesat minimale teknike të përcaktuara në fazën e parakualifikimit, ku kërkojnë porte video HDMI dhe DP. Në ANEKSI 1 të dosjes së fazës së parakualifikimit është theksuar se specifikimet teknike të përfshira janë minimale, ndërsa në fazat e mëvonshme, Autoriteti Kontraktues mund të përpilojë specifika më të avancuara për t'iu përshtatur nevojave dhe kërkesave të tij. Kërkesa për porte

HDMI dhe VGA është nën standardin minimal të përcaktuar, pasi kombinimi HDMI dhe DP është më i avancuar se ai HDMI dhe VGA.

Pergjigja nga AK Pika 2 .:

Ashtu siç është cekur në sqarimin e mësipërm, çdo specifikim teknik që është më i avancuar se sa ato të përfshira në dosjen e tenderit është i pranueshëm për AK. Prandaj, DP është e pranueshme për AK.

Pergjigja nga OE Pika 2.:

Pas pranimit të pergjigje se AK-se për piken 2, kërkojmë që AK të eliminojë kërkesën për HDMI dhe VGA dhe e njëjta të zëvendësohet me HDMI dhe DP pasi që është kërkesë minimale sipas kontratës kornize dhe specifikave baze të vendosura nga AQP në kontratën kornize. Pergjigja e AK-se që çdo specifikim teknik që është më i avancuar është i pranueshëm për AK-në le të nënkuptojë që edhe kombinimi i porteve HDMI dhe VGA është i pranueshëm edhe pse nuk duhet të jetë pjesë e kërkesës minimale pasi që është nën kërkesën baze të specifikave teknike. Pergjigje „Prandaj, DP është e pranueshme për AK.”, nuk është në linjë me specifikat minimale teknike të Kontratës publike kornize ku HDMI + DP janë kërkesa minimale. VGA Port-I është port me sinjal analog ndërkohë HDMI dhe DP janë porte me sinjal digital të cilat ofrojnë cilësi shumë më të larta në rezolucion dhe në performancë në përgjithësi.

Pergjigja nga AK dhe Ankesa e OE Pika 2: Në përgjigjen e kërkesës për ri-shqyrtim AK për këte pikë përgjigjet citoj: *„Kërkesa është parashtruar si e tillë për të ofruar sa më shumë zgjidhje të mundshme. Porta VGA dhe çdo portë më e avancuar se kjo, nuk diskriminon asnjë operator ekonomik, por ofron mundësi më të shumta për të gjithë operatorët. AK për gatit specifikat sipas nevojave të institucionit, duke siguruar zgjedhje të ndryshme“*. Kurse në specifikat teknike minimale në marrëveshjen kornize me AQP-në (UA/2016-24-3927-1-1-1), kërkohej Min. 2 porte: HDMI + DP, dhe kjo marrëveshje kornize lejon AK-të që të përpilojnë specifikat teknike më të avancuar gjatë fazës së përgatitjes së Dosjes së Tenderit, kurse AK në këte rast ka përpiluar dhe publikuar specifikat teknike nën specifikat baze të AQP-së apo minimale të kërkuara sipas marrëveshjes kornize gjë që bie ndesh me marrëveshjen kornize. Në këte pikë ne kërkojmë që kërkesa për VGA të eliminohet plotësisht dhe të zëvendësohet me DP sipas kërkesës minimale në marrëveshjen kornize.

Pika 3.: Tek ANEKSI 1, për produktet "BrandName PC Model II," "Brand Name Monitor Model II," "Brand Name Laptop Model II," dhe "Brand Name Laptop Model III," në pjesën e garancionit prej 3 vitesh, kemi specifikuar që produktet duhet të jenë sipas Kontratës Publike Kornizë me 3 vite garancion. Duke pasur parasysh që në kuadër të MAF/DAF në fazën e parakualifikimit është kërkuar që garancia të ofrohet nga prodhuesi ose distributori, siç përcaktohet në tekstin: “Ne, nëpërmjet kësaj japim garancionin tonë të plotë dhe garantojmë për mallrat e ofruara për furnizim nga ofertuesi i mësipërm në kuadër të kësaj Dosje të Tenderit,” dhe për të shmangur ofertat nga Grey Market, të cilat nuk kanë mbështetje nga prodhuesit dhe bartin rreziqe sigurie për komponentët e brendshëm si Storage dhe RAM, ju lutemi konfirmoni që garancioni 3-vjeçar i ofruar duhet të jetë garanci e siguruar nga prodhuesi.

Pergjigja nga AK Pika 3.:

Për sqarim në lidhje me kushtet e garancionit, ju lutemi t'i referoheni pjesës III të kontratës për kushtet e veçanta, respektivisht pikës 22.1, në Marrëveshjen Publike Kornizë me titull: "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative me AQP."

Pergjigjja nga OE Pika 3.: Ne kemi parashtuar pyetjen bazuar ne oferten ne fazen e parakualifikimit (detajet jane te parashturara ne kerkesen tone per sqarime), ne baze te se ciles jane lidhur kontrata per fazen e Minitenderve , prandaj kerkojme te konfirmoni qe garancioni kerkohej nga prodhuesi.

Pergjigjja nga AK dhe Ankesa e OE Pika 3: AK ne pergjigjen e dhene per kete pike ne kerkesen per ri-shqyrtim thote citoj: „ *Ju jeni pale e marreveshjes publike kornize, te paraqitura ne nenin 6 per furnizim me pajisje te Teknologjise Informative, dhe ne kete kontrate e kenei te sqaruar kete pozicion. Shih ne vijim.*

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtrëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtrërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njëfëm, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kushtet e shkakuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merri shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërprerë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Ne nenin 6 te kesaj kontrate sqarohet se furnizuesi do te garantoj per furnizime te reja, te paperdorura te modeleve te fundit. Per shkak se AK ne tabelen e specifikave teknike tek kolona e pare per te gjithë artikujt kerkon pajisje BRAND NAME, kuptohet qe edhe komponentet e ketyre pajisjeve duhet te jene Brand Name, ne kete rast edhe garancioni duhet te jete Brand Name dhe te jete nga prodhuesi i ofertuar.

Pika 4.: Tek ANEKSI 1, në specifikat teknike të detyrueshme, është larguar kërkesa për certifikimin ENERGY STAR. Kërkojmë që kjo të zëvendësohet me kërkesat minimale teknike të përcaktuara në fazën e parakualifikimit, ku të gjitha produktet duhet të jenë të certifikuara me ENERGY STAR, si një kërkesë për specifikat minimale teknike të kësaj faze.

Pergjigjja e AK Pika 4.: Meqenëse kjo është një procedurë prokurimi Minitender, të gjitha specifikimet minimale të prezantuara janë plotësisht të ndërlidhura me specifikacionin në Marrëveshjen Publike Kornizë me titull: "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative me AQP."

Pergjigjja e OE Pika 4.: Ne kërkojmë që AK të zëvendësojë në tabelën e specifikave teknike dhe të publikohet tabela e cila është pjesë e specifikave teknike të marrëveshjes kornize dhe në këtë rast AK të bëjë zëvendësimin e specifikave që i nevojiten tek ato specifika që i nevojiten të jenë me të avancuara se kërkesa minimale. Me pergjigjen e me sipërme AK le të nenkuptojë që OE-të e ndryshëm mund të aplikojnë me ofertat dhe produktet e tyre pa pasur certifikimin ENERGY STAR nga prodhuesi. Prandja, kërkojmë nga ju që të konfirmohet që produktet e ofruara duhet të jenë ENERGY Star, sipas kërkesës minimale në fazën e parakualifikimit.

Pergjigjja nga AK dhe Ankesa e OE Pika 4: AK në pergjigjen e dhënë për këtë pikë në kërkesën për ri-shqyrtim thotë citoj: *“Nuk është e nevojshme të zëvendësohet tabela, pasi në fazën e minitendereve jeni pajtuar se të gjitha produktet janë me certifikate ENERGY STAR. Ko procedure është vazhdimi i kontratës së parë, dhe si e tillë, kërkesat e specifikuara për certifikimin ENERGY STAR mbeten të vlefshme dhe të pandryshuara, duke siguruar përputhshmerinë e produkteve me standardet e fiksitetit të energjisë të dakorduara.”*. Në marrëveshjen kornizë të nënshkruar AK-të kanë të drejtë që të avancojnë specifikat teknike, por largimi i kërkesës së ENERGY STAR le të nenkuptojë që AK nuk e kërkon këtë specifike dhe e njëjta nuk është zëvendësuar me kërkesë me të avancuar, dhe në momentin që në tabelën e specifikimeve teknike largohet dhe nuk zëvendësohet le të nenkuptojë që OE mund të ofertojnë produkte që nuk kanë këto certifikime. Kërkesa jone është që tabela të zëvendësohet me kërkesën sipas marrëveshjes kornize dhe AK të kërkojë specifika teknike me të avancuara se tabela në marrëveshjen kornizë sipas nevojave të veta.

Pyetja 5: Tek faza e parakualifikimit, në ANNEX 1, kërkesat minimale teknike përcaktojnë që për secilin produkt duhet të specifikohet emri i modelit të ofruar. Në kolonën e parë, tek “Prodhuesi – Brand Name,” duhet të shkruhet emri i modelit, duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe modelin e saktë të produktit të ofruar. Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), ju lutemi konfirmoni që në ofertën teknike duhet të përfshihen marka dhe modeli i produktit të ofruar, duke saktësuar specifikat teknike përkatëse. Kjo siguron një konkurrencë të drejtë, e cila është e garantuar nga LPP, dhe u mundëson kompanive konkurruese të kenë qasje dhe mundësi për të analizuar konkurrencën, gjë që nuk mund të realizohet nëse ofertat nuk përfshijnë modele, marka dhe specifikime teknike të qarta.

Pergjigjja e AK pika 5: Sipas dosjes së tenderit, secilit produkt duhet t’i shënohet emri i prodhuesit dhe modeli i ofruar. Po ashtu, duhet të ofrohen broshura me specifikimet teknike për modelin e ofruar .

Pergjigja e OE pika 5: Ne menyre qe te kemi nje pasqyre me te sakte te produkteve dhe specifikave teknike qe ofertohen nga OE ne kerkojme qe AK te zevendesoj kerkesen qe produktit ti shenohet vetem emri dhe te kerkoje qe te plotesohen te gjitha fushat e specifikimeve teknike qe ofertohen se bashku me emrin e modelit te pajisjes qe ofertohet, pasi qe edhe katalogu/broshura jane gjenerale per te gjithë linjen e modelit me specifika dhe mund te shkaktoje konfuzitet gjate procesit te vleresimit.

Pergjigja nga AK dhe Ankesa e OE Pika 5: AK ne pergjigjen e dhene per kete pike ne kerkesen per ri-shqyrtim thote citoj:“ *deshirojme te sqarojme se eshte e rendesishme qe te ruhet struktura aktuale e paraqitjes se ofertave. Shenimi vetem i emrit te produktit dhe kerkesa per te plotesuar te gjitha fushat e specifikimeve teknike, se bashku me emrin e modelit te pajisjes, mund te kufizoj mundesite e ofruesve per te ofruar informacionin e plote dhe te detajuar qe eshte i nevojshem per nje vleresim te sakte dhe te plote te ofertave*“, kurse ne kerkojme qe AK te zevendesoj kerkesen qe te i shenohet vetem emri produktit gjate ofertes dhe te kerkoje qe te plotesohen te gjitha fushat e specifikimeve teknike se bashku me emrin e modelit, pasi qe katalogu/broshura e produkteve jane gjenerale per te gjithë linjen e modelit dhe specifikave qe mund te shkaktoj konfuzitet gjate procesit te vleresimit, kurse tabela e specifikave qe OE plotesojne secilin kolone dhe specifike qe ka te perfshire produkti i ofruar se bashke me emrin dhe modelin do te e lehtësoje punen e AK-se qe te kane nje pasqyre sa me te mire te ofertave dhe te krahasohet secila kolone e specifikave me katalogun/broshuren e ofruar.

Pyetja 6: Tek ANEKSI 1, për "Brand Name Laptop Model III," keni kërkuar madhësinë e ekranit 13". Kërkojmë që në këtë specifikim të pranohen edhe ofertat me ekran nga 13" deri në 14".


Pergjigja nga AK pika 6: Nga sqarimet e mëparshme, kemi theksuar se të gjithë laptopët me dimensione të ekranit nga 13" deri në 14" janë të pranueshëm për AK, për sa kohë që kanë specifika teknike në përputhje me ato të përcaktuara në dosjen e tenderit, pasi që konsiderohen si pjesë e së njëjtës familje.

Pergjigja nga OE pika 6: Ne pajtohem me sqarimin e dhene nga AK.

Pyetja 7: Tek ANEKSI 1, për "Brand Name Monitor Model II," keni specifikuar për altoparlantët (Speakers) si "attached or include with monitor," ndërsa tek "Other features" keni kërkuar "Integrated Speakers." Ju lutemi sqaroni nëse pranohet opsioni me altoparlantë të bashkëngjitur (attached speakers) dhe nëse ata duhet të jenë të së njëjtës markë si monitori.

Pergjigja nga AK pika 7: Altoparlantët pranohen në të dy formatet, qoftë të integruar ose të bashkëngjitur, dhe duhet që të jenë të së njëjtës markë si edhe monitori .

Pergjigja nga OE pika 7: Ne pajtohem me sqarimin e dhene nga AK.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	STORM ICT L.L.C
Adresa e plotë:	RR. TAHIR ZAJMI PN. 10000 PRISHTINE, KOSOVE
I përfaqësuar nga:	
Emri	ELION REXHEPI
Pozita	MENAXHER I SHITJES
Nënshkrimi	
Data	28.02.2025
Vula	